

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Ekonomia
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Amfiteatri i madh
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass.Luljeta Elezaj
Detajat kontaktuese:	luljeta.elezaj@uni-pr.edu +38344600550
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Studimi i lëndës “Hyrje ne ekonomi” është një hyrje e përgjithshme mbi njohuritë dhe metodat e shtjellimit të shkencës ekonomike. Shpjegimi i lëndës së ekonomisë studentëve ju ndihmon që më mirë dhe më lehtë të kuptojn, shpjegojn dhe t’i analizojnë çështjet që kanë të bëjnë me kategoritë dhe ligjet ekonomike.</i>
Qëllimet e lëndës:	
	<i>Qëllimet kryesore të lëndës janë që studentëve t’iu shpjegohen nocionet elementare të shkencës ekonomike, siç janë: resurset e limituara, zgjedhja, dobia, inputet, outputet, shpenzimet, aktivitetet ekonomike, të mirat ekonomike etj. Pas njohjes me këto nocione do të shpjegohen burimet e njohurive ekonomike, parimet e të menduarit ekonomik, për të vazhduar me njohjen e llojeve të sistemeve ekonomike dhe për të vazhduar me shpjegimin e ndërlikohjes në mes ekonomiksit dhe të së drejtës.</i>
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	<i>Aftësitë dhe shkathtësitë që do t’i fitojnë studentët pas përfundimit të sukseshëm të kësaj lënde, është që:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të kuptoni dhe të përshkruani në mënyra të ndryshme të menduarit për fenomenet e ndryshme ekonomike (mënyra ekonomike e të menduarit);</i> • <i>Të përshkruani problemet parësore ekonomike me të cilat ndeshet çdo individ: pamjaftueshmërinë dhe zgjedhjen;</i> • <i>Të përshkruani dhe të analizoni problemet bazike ekonomike, terminologjinë (gjuhën e ekonomisë) dhe që të zhvilloni logjikën racionale ekonomike;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të krahasoni marrëdhënjet në mes mungesës së resurseve, vlerës, dobishmërisë, pasurisë dhe shpenzimeve; • Të dini që të bëni dallimin në mes ekonomisë së tregut, socializmit ose ekonomisë së përzier (mikste); 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			188.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Lënda do të organizohet në formë të ligjeratave, ushtrimeve dhe konsultimeve.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i parë: 30%</i> <i>Vlerësimi i dytë: 30%</i> <i>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</i> <i>Vijimi i rregullt: 5%</i> <i>Provimi fina: 30%</i> <i>Total 100%</i>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dr.sc. Mejd Bektashi & Mr.sc. Nysret Gacaferri: Ekonomia – Botimi i dytë i plotësuar, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2005.</i> 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Terli Mings: Studimi i ekonomisë, parimet, konceptet dhe zbatimet, SHBLU, Tiranë, 1993.</i> 2. <i>John Kenneth Galbraith: Historia e ekonomisë, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2004.</i> 		

	<p>3. <i>Dr.sc. Mejdi Bektashi: Analiza ekonomike e së drejtës, Ligjerata të autorizuara për studimet Master, Prishtinë, 2006.</i></p> <p>4. <i>Grup autorësh: Hyrje në ekonomi, PEGI, Tiranë, 2002.</i></p> <p>5. <i>Paul De Grauvve: Ekonomiksi i Unionit Monetar, Botimi i parë, Prishtinë, 2006.</i></p> <p>6. <i>Zana Koli dhe Shyqyri Llaci: Manaxhimi i burimeve njerëzore, SHBLU, Tiranë, 2001.</i></p> <p>7. <i>Selman Selmanaj: Globalizimi dhe Tranzicioni, Riinvest, Prishtinë, 2006.</i></p> <p>8. <i>John Pinder: Bashkimi Europian, Hyrje e shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2004.</i></p> <p>9. <i>Manfred B. Steger: Globalizimi, hyrje e shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2005.</i></p> <p>10. <i>Joseph Stiglitz: (Globalization and Its Discontents), Globalizimi dhe dyshimet që i shkaktonë, Washington, 2002.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimet:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njohuritë elementare për kuptimin e ekonomisë, Lënda dhe objekti i studimit të ekonomisë, Definicionet dhe konceptet e ndryshme mbi ekonominë, Definicionet e ndryshme të ekonomisë (Literatura: Dr.sc. Mejdi Bektashi dhe Mr.sc. Nysret Gacaferri: <i>Ekonomia – Botimi i dytë i plotësuar, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2005, (në vijim: MB dhe NG Ekonomia 2005) fq. 11-17 dhe Terli Mings: Studimi i ekonomisë, parimet, konceptet dhe zbatimet, SHBLU, Tiranë, 1993, fq. 16-17 dhe 24-25.</i>
Java e dytë:	Rrallësia dhe zgjedhja, Resurset dhe të mirat ekonomike, Gjuha e ekonomisë, Ndarja e ekonomisë, funksionet e shkencës ekonomike (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 23-39 dhe Grup autorësh: <i>Hyrje në ekonomi, PEGI, Tiranë, 2002, fq.17-18.</i>
Java e tretë:	Burimet e njohurive ekonomike, parimet e të menduarit ekonomik, Mendimet ekonomike në periudhën antike, Shkolla merkantiliste, Shkolla fiziokrate, Ekonomia klasike, Ekonomia marksiste, Ekonomia neoklasike, Ekonomia kejnziane, Neoliberalizmi dhe kritikant, Ekonomia moderne, Ekonomia institucionale, Ekonomia pozitive dhe normative si qasje e analizës së fenomeneve ekonomike (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 41- 64 dhe John Kenneth Galbraith: <i>Historia e ekonomisë, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2004, fq. 9-18)</i>
Java e katërt:	Shkenca ekonomike dhe aktivitetet ekonomike, Dobia, nevojat dhe resurset, Analiza ex post dhe ex ante, Metodot e studimit

	të ekonomisë, Subjektet ekonomike, Institucionet ekonomike, Ndryshimi i institucioneve (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.64-79 dhe Terli Mings, 483-489)
Java e pestë:	Sistemet ekonomike dhe llojet e tyre, (ekonomia tradicionale, ekonomia e tregut, ekonomia komanduese dhe ekonomia mikste), Problemet parësore të ekonomisë së tregut, Ekonomia dhe drejtësia, analiza ekonomike e krimit (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.80-96, Terli Mings, fq.52-53, 71-74 dhe Dr.sc. Mejdi Bektashi: Analiza ekonomike e së drejtës, Ligjerata të autorizuara për studimet Master, Prishtinë, 2006, fq, 5- 20.)
Java e gjashtë:	Kapitalizmi – ekonomia e tregut, Rrethxhirimi i kapitalit, Akumulimi i kapitalit, Tregu dhe konkurrenca, Mekanizmi i veprimit të tregut, Konkurrenca dhe llojet e konkurrencës, Strategjitë kryesore të konkurrencës. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.97-111 dhe Grup autorësh: Hyrje në ekonomi, PEGI, Tiranë, 2002, fq. 134-159.)
Java e shtatë:	Oferta dhe Kërkesa, Ligji i ofertës dhe kërkesës, Ekuilibrimi i ofertës dhe kërkesës, Firmat (Ndërmarrjet) dhe organizimi i tyre, firmat individuale, firmat ortake dhe korporatat. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.112-1122 dhe Grup autorësh: Hyrje në ekonomi, PEGI, Tiranë, 2002, fq. 24-47. dhe Terli Mings, fq. 134-138.)
Java e tetë:	Format e avancimit të kapitalit, kapitali industrial dhe fitimi industrial, Kapitali tregtar dhe fitimi tregtar, Shpenzimet e qarkullimit, shpenzimet e kulluara (neto) të qarkullimit dhe shpenzimet heterogjene (prodhuese) të qarkullimit, Kapitali hua dhe kamata, Banka dhe punët bankiere. Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 123-140. dhe Grup autorësh: Hyrje në ekonomi, PEGI, Tiranë, 2002, fq. 195-222.)
Java e nëntë:	Kapitali aksionar dhe dividenta, Çmimi i aksionit, Kapitali fiktiv, Renta – e ardhura nga prona mbi tokën, Renta diferenciale I dhe II, Renta absolute, Renta monopolistike, Qiraja e tokës, Çmimi i tokës. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.140-158)
Java e dhjetë:	Llojet e monopoleve, Shoqëritë aksionare, Lidhjet monopolistike, Format e ulëta dhe të larta të lidhjeve monopolistike, Format e monopoleve sipas numrit të pjesëmarrësve, Monopolet dhe konkurrenca. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 159-167)
Java e njëmbëdhjetë:	Paraja dhe funksionet e parasë, Çrregullimet në sasinë e parasë në qarkullim, Inflacioni- historiku dhe pasojat, Shkaqet dhe llojet e inflacionit, Pasojat ekonomike, politike dhe sociale të inflacionit, Devaluimi (Devaluation), Deflacioni (Dezinflacioni), Nulifikim (Denominimi), Stagflacioni, Bankat dhe sistemi bankar, Zhvillimi historik i bankave (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.170-191 dhe Paul De Grauvve: Ekonomiksi i

	Unionit Monetar, Botimi i parë, Prishtinë, 2006, fq. 42-43 dhe 188-193)
Java e dymbëdhjetë:	Ciklet ekonomike (Konjunkturale), Teoritë e zhvillimit ciklik të ekonomisë, Punësia dhe papunësia, Papunësia, llojet dhe pasojat, Shkaqet e papunësisë, Determinantet e ofertës së punës në tregun e punës, Diskriminimi në tregun e punës dhe dallimet në paga, Punësimi i forcës punuese dhe tregu i punës, Sindikatat, Anëtarësimi në sindikata, Sindikatat ndërkombëtare, Dialogu social dhe kontratat kolektive të punës, Çka përmbanë marrëveshja kolektive e punës?, Qeveria, punëdhënësit dhe sindikatat (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.192-218, Paul De Grauvve: Ekonomiksi i Unionit Monetar, Botimi i parë, Prishtinë, 2006, fq. 19-20 dhe Zana Koli dhe Shyqyri Llaci: Manaxhimi i burimeve njerëzore, SHBLU, Tiranë, 2001, fq. 255-281)
Java e trembëdhjetë:	Ekonomia e hapur dhe tregtia ndërkombëtare, Shtimi dhe zhvillimi ekonomik, Periudha e tranzicionit, Karakteristikat e ekonomive të tranzicionit, Masat parësore që duhet të ndërmerren gjatë periudhës së tranzicionit, Politika tregtare e lirë dhe proteksioniste. (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 219-234, Selman Selmanaj: Globalizimi dhe Tranzicioni, Riinvest, Prishtinë, 2006, fq. 91-120.)
Java e katërbëdhjetë:	Integrimet ekonomike, Paraqitja e integritimeve, Bashkimi Evropian, funksionimi dhe rezultatet, Cilat janë qëllimet parësore të integritimit ekonomik?, NAFTA, mekanizmi, funksionimi dhe rezultatet, Organizata Botërore e Tregtisë, Tregu dhe infrastruktura e tregut, Kur shteti intervenon në ekonomi? Kush qeverisë në ekonominë moderne? (tregu apo shteti), (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq. 235-247, John Pinder: Bashkimi Evropian, Hyrje e shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2004, fq. 13-45.)
Java e pesëmbëdhjetë:	Masat dhe legjislacioni antimonopolistik, Ndërmarrësi dhe ndërmarrësia, Globalizimi si model i zhvillimit dhe sfidat e globalizimit, Përsëritje dhe pyetje dhe përgjegjje (Literatura: MB dhe NG Ekonomia 2005, fq.248-254, Manfred B. Steger: Globalizimi, hyrje e shkurtër, Co-PLAN, Tiranë, 2005, fq. 55-75, dhe Joseph Stiglitz: (Globalization and Its Discontents), Globalizimi dhe dyshimet që i shkaktonë, Washington, 2002)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;
- Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);

- *Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimi;*
- *Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.*

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*